

S. Laimani
'37

VITI I VIII.

— SHKURT 1937 —

Nr. 3

Vlera e njeriut nuk qëndron
në dijen, por në
vullnetin e fortë

HERBART.

Normalisti

Mbrendija

Ç'farë dënim?

Edukata funksionale, parimet dhe randësija e 'saj.

Përgjegjja.

Shqipja një gjuhë e përbotëshme.

Dobija e ushtrimit në periudhën e njomë.

Kemi nevojë për njerës me karakter.

Provë Mësimi.

Provë Mësimi.

Provë Mësimi.

Çpifje. Gjykatës! Valet dhe Retë.

Shërbimet që u sjell shkencë popujve.

Fshatari i vogël dhe Skënderbeu.

Kristina (novelë)

Mendime, dhe 4 faqe Folklorë.

Shtypshkronja "SAIDE", Elbasan.

Muzeu i Shkollës Normale

Normalisti

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkëncore
DEL NJI HERË NË MUAJ.

E botojnë nxânësit e Normales

Editor: Harilla Kuçuli '37.

Sekretar: Kol Lekaj '37.

Arkëtar: Jovan Gjerga '37.

Ndihmësit

Tajar Reovica '38.

Panajot Foto '38.

Koço Mosko '39.

Drejtimi

E përkohëshmja "NORMALISTI,"

Shkolla Normale

Elbasan

Dorëshkrimet nuk kthehen.

Pajtimet:

Për mësues

Copa lek 1.25

Për gjithë vitin fr. ar. 1.50

Për nxânës

Copa lek 1.

Për gjithë vitin fr. ar. 1.

NORMALISTI

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkencore

DEL MUAJ PËR MUAJ

E botojnë nxënësit e Normales.

VITI I VIII.

— SHKURT 1937 —

Nr. 3

Ç'farë Dënimi?

Qeverimi i një shkolle të mesme ideale s'është as një problem militar as një problem policije siç ka qënë në shkollat e vjetra prapanike.

Qëllimi i shkollës së re e progressive është që në funt e në kryet produkti i mësimi; sjellja e nxanësve është provimi i rezultatit të këtij produkti. Dhe që të harrihet ky rezultat, pikë së pari shkollës i nevojitet një udhëheqës me personalitet të fortë e me karakter të shëndoshë që të krijojë një shkollë me integritet, dignitet, dhe moral. Drejtori, jo vetëm që duhet të zotërojë disa parime morale. si vërtetësi, qindrim të njëjtë, patriotismë, sinqeritet, e drejtësi, por duhet edhe t'i praktikojë këto gjithëmonë që të jetë vetë pasqyra e parë e moralit e e virtytit. Ay duhet ta imponojë veten si në nxanësit ashtu edhe në profesorët me një mënyrë që, kudoherë që emëri i tij të dëgjohet, të parafytyrohet si një personalitet i kthjellët, si një personalitet q'është bërë sinonim

me parimet morale e shoqërore më të larta.

Por Drejtori vetëm pa ndihmën e profesorëve s'munt t'i mbajë kollaj standartet e larta të shkollës së tij. Ay duhet të ketë edhe profesorë që janë shëmbëlla të një kondukti të përqyeshmë të sjelljeve të mira dhe ta kenë bërë si natyrë të dyjtë dëshirën e studimit, e bashkimit dhe bashkëpunimit, dhe e jetës së paqtë. Është afër menç të mos prejç një jetë morale nga nxanësit kurse profesorët e tyre s'kanë ide se ç'janë parimet e kësaj jete morale. Këtej t'u thuash nxanësve të bëhen të mbarë, të mos gjesdisin rruqëvet më kot, të mos gënjëjnë, të mos bëjnë intriga, e të mos lozin kumar, dhe më anët tjetër të kthehesh e t'i bësh vet këto, është një marëzi. Nxa-nësit s'munt të kenë respekt për këshillat e njeriut që s'i zbaton vetë.

Nuk dua as pax të them se një shkollë me parime morale të larta e me persnel me karakter s'do të ketë probleme disipline. Një ogjë e tillë

është utopi. Por është një fakt se në një shkollë, ku bazat morale janë me themel dhe jo principe, problemet disiplinore janë më të pakta e zgjidhen më me lehtësi. Gjëja më me rëndësi është se si do të veprosh kundër një problemi të tillë. Është e tepërt të përmëndim se qëllimi i çdo dënimi është që të ndreqet e të mos përsëritet gabimi. Dhe që të kupëtohet ky qëllim s'është aqë i lehtë siç duket. Një nxanës shkeli një nga rregullat më me rëndësi të shkollës, bie fraja, u-zu në të lojtur letrat. Tani si do të dënohet ay për këtë faj që hëm të mos e përsëritë, hëm të përfitojë nga eksperiencia e hidhur?

Zakonisht këtu në Shqipëri kur nxanësit abuzojnë rregullat, përjashtohen nga shkolla për një kohë të caktuar; ose më mirë të themi nxiren nga shkolla që ta kalojnë kohën rrugëve. Pa një pa dy një veprim i tillë i vë damkën arësimit t'onë të mesmë si një nga më prapanikët në Europë. Një dënim i tillë është kundër praktikës të pedagogjisë moderne. Thamë më sipër se dënimi ka për qëllim korrektimin e fajit. Në qoftë kështu, ahere ç'mësim u jepet nxanësve duke i lënë rrugëve? As gjë fare. Bile nga dëshpërimi që ndjen, nga rrethanat e këqija, dhe nga pëpunësia, ay në vënd që të pendohet për fajin, do ta vazhdojë e do ta shumojë atë. Kështu që në vënd që nxanësve t'u ish dhënë një mësim për fajin, ata shtërngohen nga mënyrat e shkollës të pasojnë po gjithë atë rrugë. Dhe dëndur përfundimi do të jetë çkatërrimi i jetës së nxanësit.

Që nxanësi i padisiplinuar duhet

dënuar s'ka as pak kundërshtim. Vetëm se mjeti dhe mënyra t'i përshtaten dënimit. Në vënd që në këto dy javë ose një muaj nxanësi të flakej jashtë shkollës, ay përkundrazi duhet mbyllur në 'të. Atij duhet t'i jepet një detyrë mjaft e veshtirë, por edhe edukonjëse. Si dënim drejtori ose profesori munt t'i caktojë atij një lëndë veç mësimi të përditshme që duhet medoemos ta përn barojë. Për shembëll, për një faj profesori i gjuhës ti caktojë nxanësit një hartim shumë të rëndë veç detyrës së përditshme. Ky nxanës tani do të lejojet të vinjë në klasë, por do të rinjë më një anë që hem ay të jetë në dijë për fajin e tij hem bashkënxanësit ta ostrakisojnë. Do të futet në rrethin e klasit përsëri vetëm kur dhe po ta mbarojë hartimin. (Hartimin e solla vetëm si shembëll. Detyra ose dënimi munt të jetë histori, matematikë, ose çdo farë tjetër punë që Drejtorija e sheh të arësyeshme). Përfundimi do të jetë që nxanësi jo vetëm s'është lënë rrugëve, dhe jo vetëm q'është shtërnguar të punojë më rëndë se kurdoherë, por edhe koha e tij s'ka shkuar më kot. Nga ky dënim ay hem është diskredituar nga shokët hem ka përfutuar në fushën e mësimi. Vetëm ahere munt të justifikohet dënimi kur nxanësi ka bërë një përmirësim moral e mendor.

Më sipër thashë se nxanësi i fajshëm duhet të nxiret jashtë rrethit të shoqërisë nga kolegët e tij. S'ka dënim më të math për një nxanës se kur e tërë shkolla i jep atij të kupëtojë se ay ka abuzuar një nga rregullat e asaj shoqërije. Por që të ketë rëndësi për nxanësit një rregull, ata

duhet të marin pjesë në formimin e këtyre rregullave: Në vënd pra që Drejtoria të çpallinj disa rregulla dhe urdhëra, do të qe shumë më mirë që në kryet të vitit shkollor tërë nxanësit të thëriten në një konferencë ku me ndihmën e drejtorisë të formojnë vetë tërë rregullat morale e shoqërore të shkollës. Kështu që, kur një nga ata prish no një nga këto rregulla, e tërë shkolla do të ngrihet kundër tij. Në rasë të tillë nxanësit jo vetëm që do ta qërtojnë, por edhe nuk do ta simphathizojnë siç bëjnë me mëny-

rën q'është tani në zbatim. Mënyra që përdoret në shkollat e mesme atje ku i nënëshkruari është mësuar është që sapo një nxanës shkel një rregull, tërë nxanësit ngrihen më këmbë dhe dënojnë vetë atë me anë çpalljes që ngjiten në tërë dhomat e shkollës. Kështu sigurohet vet qeverimi, vetveprimi, dhe bindja e nxanësve. Dhe s'ka as një arësye sepse një spiritë e tillë për bindjen kundrejt rregullave të mos vendoset edhe në nxanësit Shqipëtarë.

Stefan Treska

Edukata funksionale, parimet dhe randësija e 'saj.

Shum mendime janë çfaqë dhe çfaqen në çdo herë e në çdo popull prej dijetarësh dhe pedagogësh të ndryshëm. mendime të bazueme mbi nevojat e ndryshme të këtij populli për gjallnin, zhvillimin e përparimin e tij, mbi shoqnin, mbi idët morale dhe doktrinat filozofike e mbi psikologjin e fëmis. —

Nga të gjithë kta faktorë, të cilët caktojnë qëllimin e edukatës, ai që është më i arsyshëm është të mbështunit e edukatës mbi psikologjin e fëmis; ky pra, më tepër se të tjerët, duhet të zotnojë, t'udhëheqi, të jetë pika e nisjes, poli i veprimi, burimi dhe gjaja më e qënssishme për një edukatë të vërtetë dhe faktorët e tjerë do të jenë si pasonja të natyrshme të këtij. —

Edukata, që përipiqet më tepër se çdo tjetër me e mbështetë veprimin e saj mbi psikologjin fëmimore, është ajo funksionale, e cila edukatë, e predikueme sëpari prej J Dewey-t e William James-it me emna të ndryshëm, është përdorë për herë të parë me kë të emën prej psikologut të famshëm

Claparède-it, dhe që mund të formulohet, kështu: „Edukata funksionale është ajo edukatë, e cila ka për qëllim të shtjellojë përshkesat (processus) mendore (vemendje, kujtesë, fantazi e tj.) tue i vëzhguem jo në vetvehte, porse për sa i përket domethanjes së tyne biologjike, rrolit dhe dobis për veprimin e tanishëm dhe t'ardhëshëm, për jetën. Edukata funksionale është ajo që merr nevojën e fëmis, interesin e tij për t'ia mbërrimë një qëllimi si manivelë të vepris (activité) që dëshirojmë me më zgjue ke ai.(!) —

Parimi kryesuer i këtij mendimi sikurse duket nga përkufizimi i nalt përmendun është të mbështetunit e edukatës mbi nevojën, interesin, dhe dëshirën e fëmis, mbassi apostujt e kësaj edukate me vëzhgimet dhe përsiatjet e holla të tyne e me eksperimentet e ndryshme krejt objektive e subjektive (vetëverejija) janë përcuem dhe janë bindë kryekput që „çdo veprim i njeriut oso i kafshës është lindun prej një

¹⁾ Dr. Ed. Claparède: Education fonctionnelle f. 7-8

nevoje, e cila përpiqet me ngërmuem reaksjonet e vulltshme për t'u përmbushë.')

Nji shembull e jetës së përditshme do të na bájë që ta rrokim më mirë shpirtin e kësaj edukate: marrim për shembëll nji njeri t'urishëm (nevoja) të përpjekunit dhe interesimi i tij për të gjetë nji gjá ushqimore (interesi, dësl ira), të ngranunit e ksaj gjáje (plotsim i nevojës) Çdo veprim i individit pra nuk áshjt tjetër, veçse plotsim' i nji nevoje çfarëdo qoftë —

— Me e mbështetë edukatën mbi interesin, dëshirën dhe qejfin e fëmis, thonë kundërshtarët e edukates funksionale, d. m. th. me e lánë fëmin të bájë ç'të detë; në kët mënyrë, jo vetëm qi koha humb kot dhe vlera e shkollës dhe e disiplinës bije poshtë, porse edhe fëmin e bân të pazotni me rrue má vonë në jetët e cila áshjt plot me vështirsina të ndryshme, që kërkojnë nji vullnet e karakter të fortë e të stërvitun për t'ua dalë në krye. Kështu pra fëmija, tue mos qenë i mësucm qysh në vogëli me u-dhánë mbas nji pune pa interes e, tue mos pasë fituem shprehin me i vù mendë disa fakteve vetëm e vetëm, pse duhet me i vu mendë e pa marrë para sysh kënaqsít, që mund të nxjerri, atëhere përpara punëve serioze, ose karakteri e tij do të thyhet, ose do t'i shmanget luftës. Ja pra përfundimi, që nuk mund t'i reshtet edukata funksionale: **Fëmija i prish, që nuk bân, veç se atë që don të bájë.**) —

Ja ç'far kritike e pamendueme, ç'far keqkuptimi dhe ç'far illuzioni për edukatën funksionale. Kjo edukatë nuk e bën fëmin "të bájë ç'të detë", sikurse e padisin, por përpiqet që fëmija të detë ç'të bájë, gjá qi nuk áshjt njilloj, sepse áshjt e vërtetë

¹) Dr. Ed. Claparède: Education fonctionnelle f. 57

²) John Dewey: L' école et l' enfant f. 44.

që, në qoftë se e lijsnin fëmin të bânate ç'të donte, atëhere kjo do t'ishte nji dâm i math për atë, mbassi intereset e fëmis e kapërxys (transitoires), janë **foksi ne të vrullshme**, e me i ngulë, tue i punuem po n'at formë me të cilën çfaqen, kjo do të thoshte me e ndaluem shjtellimin e fëmis. Përkundrazi puna qëndron me i vëzhguem kto interese si shënja, që na zbulojmë nevoja má të fella, virtualitete, funksione të reja, që kërkojnë me lindë, e që edukatori duhet me u ndifmuem, tue e vendosë fëmin në rrethanat má të favorëshme për të çelunit e tyne. Për me njoftë kto nevoja, duhet pra me doemos me interpretuem kto shënja, d. m. th. me kërkuem ndën interesin, i tillë që çfaqet sot, veprin má të fellë, e cila kërkon që të dali në dritë.

Tue vepruem në kët mënyrë, edukata funksionale ia mbrin má lehtë asaj që kërkon edukata tradisionale: **me e bájë fëmin të zotin për jetën**, e cila áshjt ambicja má e madhe, ideali má kryesuer dhe objektiv rreth të cilit përmbidhen të gjitha fuqit e përpjekjet e ksaj edukate (funksionale)

Në pikpamje të funksionit pra ambicjet e të dy metodave janë të njëjta, mirpo ndryshimi qëndron në teknikat e ndryshme që përdorin secila nga kto të dyja: kurse edukata funksionale përpiqet që ta bájë fëmin të zotin për jetën tue e stërvitë ktë (fëmin) që ta rrojë me të vërtetë jetën qysh në vogëli tue ia paraqitë çdo gjá, që do t'i mësojë si nji përmbushje të nji nevoje të natyrshme të tij, ose tue formuem nji rreth të tillë, që të lindin kto nevoja, edukata tradisionale, me gjithë që kërkon po nji gjá, e zhyt fëmin në nji vend kaq të largët, të huej (huej) e mjeshtëruer në krahasim me jetën e vërtetë, saqi, kur të dali ky i mjerë nga nji e tillë

Duke bërë fjalë për politikën e Shtetit, e pyetën një ditë shkrintarin Michelet: "Cila është pjesa e parë e politikës?," Ay u përgjegj: Edukata. E dyta? Edukata — E treta Edukata.

shkollë, do të jetë përkundrazi i pazoti a me i bā ballë jetës, mbassi nuk është mësues qysh prej së vogëli me e rrue këtë. — Nuk është ky që është konsideruem si pika e gravitacionit në shkollë, por mësuesi e programa, të cilat kanë zotnuem në shpirtin e tij, e kështu në vend që përfundimi i kësaj sisteme të jetë, sikurse pretendon vetë formimi i karaktereve të fortë, në njimendësi e në praktikë nuk kontsatohet një mrekulli e tillë; formon njerëz të ngushtë nga shpirti, kokëfortë e të mbyllët për çdo gjë që nuk është ideali i tyre, ose njerëz të fikët, mekanikë, pa shkathtësi. mbassi langu jetsuer i interesit të vetvetishëm të tyre iu ka pasë hekë ç'me kohë. —

Qe se me ç'far termash prekëse e plot kuptim e çfaq Claparède-i gabimin trashanik të kësaj sisteme: **"Ja monstrooziteti, që me ndifmën e forcës së rutinës e të tradisjonit, syt e shumicës s'edukatorëve nuk e kanë pa e nuk e shofin: me marrë atë që është mē e gjallë në botë, një fëmijë e ndën pretëkstin me i mësues të rrojë, me e zhytë, me e ngurrosë në një rreth (milieu) shumë të largët nga jeta, d. m. th. në rrethin shkolluer! Me i ndaluem, n'emën të disiplinës shkollore, reaksionet shoqnore mē elementare, që do ta përçojshin në qëllimin e dëshiruem (me ubā i zoti për jetën)".** — »

Por, si do që të jetë nuk është faji i tyre (tradisjonalistëve) por i rutinës, këtij helmi kaq të fortë e të fuqishëm të përparimit, të zhvillimit njerzuer e të çdo gjëje të rē, helm që e ndryth dhe e ngath kaq fort mendjen e njeriut, që ka ranë

viktimë i kësaj dhe ia ngushton kaq shumë fushën e të pamunit saqi nuk e lanë kurrë që të vëzhgojë, të krahasojë e të pranojë idet e mendimet mē të vërteta, të drejta, mē t'arsyeshme e mē të natyrshme, vetëm e vetëm se nuk pajtohen e binë në ndesh me ato, që janë ngurrosë në trūnin e tij nga forca e praktikës së rutinës së deritashme. —

Për t'u-bindë mbi bazat e gabueshme e të panatyrshme të kësaj edukate dhe mbi bazat e shëndosha dhe të natyrshme t'asaj funksionale, nuk është nevoja të mundohemi shumë por mjafton të vëzhgojmë me kujdes në vehten t'onë shkaku e afërm e të largët të çdo veprimi që bëjmë, kujtimet që kemi për ato sende që i kemi nxënë kundër dëshirës e t'atye që i kemi nxënë me interes dhe me qejf dhe do ta shofim mb'at çast ndryshimin; mē tepër të vëzhgojmë fëmijn se sa me qejf dhe me gjithë shpirt ipet mbas një gjaje, që e intereson (pralla, kukulla, loja e tje tj). —

Me e mbështetë një veprim mbi një tjetër mobil veçse atij t'interesit, d. m. th. me e nda këtë (veprin) nga burimi i natyrshëm e me ia humbë arsyen e të qenunit, mbassi, si mbas filozofit pragmatik Amerikan J. Dewey: **"Asht psikologjikisht e pamundur me provokuem një veprim pa ndonji interes (2)".**

Edukatori pra, si i tillë që ka të bëjë mē shumë se kushdo tjetër me fëmijë, për të cilët është nevoja mē tepër se për të madhin me ia mbështetë çdo veprim mbi intere in, duhet të ketë si parim themeluer **funksionalizmën n'edukatë.** —

Gjenevë. 5 I. 1937.

M. Dau

¹⁾ Claparède-i: Hommage à Decroly f. 49-50.

²⁾ J. Dewey: L' école et l' enfant f. 42.

Loja është ura që lith fëmijën me jetën, përtej murit të shkollës

Dr. E. Claparède

Përgjegje?...

Pata qejf që mejtimin t' im për mbi përmirësimin e mësimin t' hartimit ta çfaq, pasi të dëgjoja më parë edhe mejtimin e më kompetentëve, për mbi këtë çështje. Edhe kjo vjen nga që e ndiej vehten jo në pozitë të duhur, për të bërë fjalë mbi një çështje, që është bërë me të vërtetë problemë, e bile problemë rreth së cilës përleshën pedagogët më në zë të botës, duke e mos mundur t'ia japin akoma thjeshtësin' e nevojshme.

Por ajo që më shtyri e më bëri të guxoj me nxjerrë trupthin t' im para atyreve (kompetentëve), është shpresa se mos bëhem kështu shkaktar që të marrin edhe këta pendën në dorë, e të na ndriçojnë mbi çështjen në fjalë, e në shumë të tjera si kjo.

Jo pakë ndihmoi në këtë edhe ideja që kam, se çdo punë që bëhet për herë të parë për mbi një system të ri, qofitë ky origjinal. ose jo, dhe sjell, sido, përfundime më të mirë, nga ata që sillte system' i vjetër, duhet të botohet e të vëhet para gjykimin të të gjith atyreve që kanë një idë, pse vetëm kështu do të jetë e mundur të gjëndet mënyra më e përshtatëshme simbas së cilës duhet të bëhet puna që të sjellë përfundime më shumë e më të mirë.

Porse, përveç këtyre, kam edhe një arsye tjetër të një rëndësie jo të vogël, që po nxitohem. Sepse, po t' a thellojmë pakës çështjen do të shohim se, për në mësuësit — si edhe për profesorët e gjuhës akoma — kjo është një çështje nderi pse, nga zotsija ose jo, që tregojnë nxënësit në përpilimin e ndo një letre, të ndonjë lutjeje e të ndonjë çfarëdo shkresë tjetër, gjykohet edhe e tërë puna e jonë shkollorë!...

Duke qënë pra, puna kështu duhet të presim edhe më?

Kur, në vitin e parë t' ushtrimit të profesionit t' im, përpiquesha, me zellin që dallon mësuesin Shqiptar, për t'aplikuar edhe në mësimin e hartimit gjithçka kisha

mësuar, në Shkollën Normale, për mirë-zhvillimin e këtij, me gjith, them insistimin e përpjekjen t' ime për t' a bërë edhe këtë mësim më të thjeshtë, më të këndëshëm e më fryt dhënës, më në fund pashë se përfundimet e këtij, nuk e shpërblenin si duhej mundimin e kohën që shpenzoheshin për të!...

Duke u-gjëndur, pra, para një gjëndjeje të tillë, mendodhësha, se kujit duhej t' ia hedh fajin, mësuesit? Nxënësit? Bangavet? Shkollës? Apo të gjithëve së bashku? ..

Rrugën e drejtë mund të them se e gjeta më vonë, kur më ra në dorë një nga librat e shumta të pedagogut të shquar Gjermane, Paul G. Münc, i cili është një nga përkrahësit më guximtar e më të zjarrtë të Shkollës së punës.

Auktori në librin e tij, me titull: "Sigurisht fajin e ka shkolla., pasi u-përgjigjet akuzuësavet të shkollës së re, në një mënyrë bindëse, kritikon ashpërisht systemët e gjer djeshëm, dhe, si për mësimet e tjerë ashtu edhe për hartimin, tregon rrugën që duhet të ndjekë mësuesi, për t' a bërë edhe këtë më fryt-dhënës

Ndrejqa e gabimeve, thotë, kështu si bëhet sot nuk iu-sjell asnjë dobi nxënësve pse, vijat e kuqe me anën e të cilavet shënjohen gabimet, jo vetën që nuk tregojnë kurrëgjë për nxënësit, porse u shkaktojnë edhe një dëshprim të math këtyre, kur këto (vijat) dëndësohen në defterët e tyre. Duhet pra, të veprojmë ndryshe.

Edhe shton, se: "mësuesi që kërkon prej nxënësve hartime të mirë, duhet që ai më parë të japi shëmbëllën për këtë gjë, duke e shkruar edhe vet hartimin, që u-jep nxënësve, dhe, pasi n' orën tjetër të hartimit t' i ketë ndreqë gabimet në defterët e nxënësve i u a këndon edhe ai hartimin e tij ose më mirë i a jep ndonjë nxënësi që t' a këndojë dhe ai ulet në bangë bashkë me nxënësit..."

Kuptohet vet-vetiu se mësuesi hartimin nuk e këndon, për të çuditë nxënësit e për t'u-lavdëruar prej tyre, për zotësinë a talentin e shkrimit, as për t'iu bërë konkurrencë atyreve, gjë që duhet t'iu a shpjegojë mirë....

Kështu shkaktojmë që, në hartimet e më pastajshëm, dikush prej nxënësve të përdorë këtë fjalë që i pëlqeu nga hartimi i ynë, dikush atë e një tjetër ndonjë fjalë tjetër.

E duke vepruar në këtë mënyrë e ngrëmë qendër rëndimin e përmirësimit të stilit e të pasurimit të gjuhës së nxënësve,

nga kujdesi i kalemit të kuq.

Ky është sistemi, që kam adaptuar në mësimin e hartimit të klasës së pestë, system në të cilin nxënësit shohin e mendojnë se, sa i bukur e i këndëshëm bëhet hartimi i that i tyre, kur shkruhet një ashtu si duhet. Dhe ky mendim i u a mban interesin të gjallë e dëshirën të flakët, për t'arrijtur edhe ata në gjëndje që të shkruajnë mirë e bukur....

Dhe kjo është mjaft.....

Lushnjë, më 29. 1. 1937

Nikolla Burbo

Shqipja një gjuhë e përbotëshme!!....

Me qindra herë është përmendë çashtja e gjuhës, por askush nuk ia vë mendjen Punë e madhe Mâ në fund ç'na duhet shqipja? Mjafton që të merremi vesh e të shfaqim mendimet e idetë t'ona Kështu mendojnë disa. Por le të mos harrojmë se me gjuhën lidhen shumë sende... Si mund të humbim e të prishim këtë, humbim dhe të tjera mâ të vjeshme, të cilat lidhen me çashtjen t'onë jetike si komb.

Nuk them se duhet t'i përbuzim gjuhët e hueja. Përkundrazi, këto duhet t'i mësojmë me qëllim që të përfitojmë nga veprat e tyre gjithfarësh, të cilat kanë një dobi për zgjimin e përpërimit t'onë. Por jo edhe ta përziejmë gjuhën me shumë fjalë të hueja tue dashë të tregojmë se dijmë diçka ose për t'i bëmë qejfin të tjer-vet... Mirpo ky zakon i keq po vjen gjithnji tue u-forcëue. U bā si modë e folmja në gjuhë të huej ose në shqipe të përzieme.

Mue më vjen keq për ata zotnij, të

cilët përpiqen me gjetun një gjuhë, e cila të merret vesh prej gjithë botës! Çuditë se si nuk fusin në përdorim këtë shqipen t'onë, e cila besoj se është bā një përmbledhje e grumbullim fjalësh të hueja! Lum si na! Do të vijë dita e bardhë, kur shqipja të bāhet një gjuhë e përbotëshme! Pse të mos mburremi?!...

Disa ankohen e thonë për t'i dhënë të drejtë veshes, se gjuha e jonë është e vorfën nga fjalët; me këtë nuk mund t'i shfaqish të gjithë mendimet të cakët e të kthjellët. Kështu thonë... Por nuk kanë të drejtë aspak. Për këtë kemi shembulla, të cilat na provojnë të kundërtën Përkthimi i shumë veprave letrare, psikologjike e dramatike, të cilat kanë me të vërtetë idë e mendime të nalta, na tregon se edhe gjuha e jonë është e pasun nga fjalët e mjafton për me shfaqun gjithëfarë idësh.

Edhe gjānat mâ të thjeshta nuk mund t'i shfaqim shqip. Deri në letrat private do të gjëjsh një çorbë fjalësh të hueja. Në

Të nxësh? sigurisht, por më parë të jetosh e të nxësh me anën e jetës, brënda në jetë.

JOHN DEWEY

bisedime ndëgjohet **hashafi** e mish-mashi i shqipes. Në zyra, në aktet, në lutjet, në tabellat e tregtizavet, në shpalljet shifen fjalët e hueja **bombastike**. Në gjelltoce, në udhëtim, në karrocë, në automobil gjithnjë fjalë të hueja, këngë të hueja, çdo gjë e huej kurgjâ e jonë!

Kjo është një mungesë, e cila dëftën formimin e rregullimin e keq t'onin.

Kam ndëgjue me veshët e mij gjithëfarë bisedash. Nuk është nevoja t'i rrjeshtoj këtu, se ato njëfen e kuptohen vetë, në qoftë se i vëmë mendjen me kujdes.

Kush mund përkthen. Një tjetër shkruen vetë. Sidoqoftë mjaft që shkruemë e përkthejmë, por s'ka gjâ pse nuk gjân një periudhë ose fjali të thjeshtë shqipe.

Shqip! E pse me folë e me shkruer shqip?, "Kurse — me 'i gutn' morgen e një kalimera e një dobravecet e një buona sera,, i shfaqim bukur të gjithë përshëndetjet t'ona Kështu thotë A. Fishta me Anzat e Parnasit.

Çdo njeri e di një gjuhë të huej, me qëllim që të studjojë veprat e 'saj dhe e flet, kur të ketë nevojë. Por jo ta flasim për **elegancë**. Në qoftë se ndonjë prej nesh do të flasij e të shkruer me **elegancë**, atëherë duhet të dijë më parë shqipen e vet e të shkruer fjesht shqip. Në ato pak vepra, që kemi në gjuhën t'onë, do të mësojmë e do të përfitojmë shumë sende.

Qukapiku

M. Boigey. — La cure d'exercice. Paris 1934.

Dobija e mësimit në periudhën e njomë (para-pjekmënis) (prej 7 deri në 13 vjeç).

Fëmija, djal e vajzë, në këte periudhë është në rritje e sipër; ai ka nevojë, para së gjithash, për një shëndet të plotë. Të mos i imponohet asnjë send; veçanërisht, në këte fazë të jetës, nuk duhet t'i zhvillohen musklet.

Në krejt kohën e fëminis eshnat janë relativisht të buta; veç kësaj musklet nuk kanë, në krejt kohën e kësaj periudhe pika lidhjeje të forta.

Të ndalohet pra me e ndënvumë fëminin, si në manevrat e forcës ashtu edhe në ushtrimet e para, për arsye se me ta i japin shkak shtangëjes së musklevet. Kto të fundit, të zhvillueme jashtzakonisht prej një gjimnastike të pakohshme e me anë lojnash të papërshtatuna, munden, deri diku, t'i pengojnë fëminis zgjatjen e shtatit, nga qi ia zhvillojnë trupin para kohës.

As ndonji herë nuk kanë qenë llogaritë këto rregulla fiziologjike; përkundrazi na ka ndodhë shpesh-herë të shofim fëmij

të njomë qi i kanë vu në praktikimit t'atletizmës, me anën e së cilës fitojnë shtrëmnime të shënueshme në trup; me gjithë atë populli i brohorit këto me entuziazëm! Brohorit një gabim fiziologjik. Disa prej ktyne atletëve të çuditshëm i kanë musklet të zhvillueme jashtë masës; shtati i tyre mbetet i pitë dhe nuk ka me e fitue kurrë zhvillimin së gjati qi i jep trupit të njeriut proporcione të bukura; ata kanë m'u b' "shkurtabiqë,, shtat-gjënë, pa hijeshi e pa shkathtësi.

Për fëmij ma të vegjël se 12 vjeç edukata fizike duhet të jetë hygienike. Kjo duhet të përpiket me zhvillue veprimet e mbëdhâ t'organizmit; të marrunit frymë, qerthëllimin e gjakut, lidhjet, etj. Veç kësaj të ketë për qëllim me perfeksionueme bashkveprimet e nervavet; por në çdo rast të mos u zhvillojë sistemakisht musklet.

Përpara subjektevet të pa deformueme, duhet me lënë mbë nj'anë sforcimet loka-

le; i gjithë kujdesi i mësuesit duhet të jetë n' ushtrimet që nxisin punën e njiherëshme të shumë musklevet, shpejtojnë rrahjet e zemrës e lëvizjet e të marrunit frymë. Pesë minuta kërcime në litar venë në lëvizje më shumë të marrunit frymë e qerthëllimin e gjakut dhe e ngrohin trupin më shumë se 10 minuta gjimnastikë analitike. Para së gjithash pra duhet me kërkue dobina hygjienike.

Mësuësët nuk duhet kurrë t' i japin fëmijvet prej 7 deri në 13 vjeç nji përshkrim verbal t' ushtrimevet. Ata duhet t' i thonë: "bani si unë..", të vendosen para tyre e të bajnë lëvizjet që duen, tue i përsëritë disa herë; mandej t' i bajnë njikohë sisht bashkë me nrxanësit.

Për fëmij 13 ose 14 vjeç dobija e ushtrimet është e shpejtë, atëhere kur navzi (puls) mbrrin me rrahë rreth 100-140 herë në kohën e më se nji minute, kur të marrunit frymë shpejtohet pak e kur nji farë mektësije e likurës vërteton daljen e djersës.

Deri në 13 vjeç edukata fizike duhet të jetë objekt i kujdesit mjeksuer: nuk është e mjaftë që mjeku të vijë në shkollë

për me pamë aty hygjienën para çdo gjaje e mbasandej zhvillimin e edukatës fizike; ai duhet të jetë bashkëpunues i mësuesit t' edukatës fizike.

Në këte periudhë të j'tës, çdo provë tjetër nuk është e mundëshme veç provës mjeksore; është mjeku ai që do t' i kategorizojë fëmijt e shëndetshëm sa është e mundun të nji vlefte fiziologjike, tue i bashkue në grupe që do të zhvillojnë ushtrime ose lojna të veçanta.

Ja si mund të përmblihdhet lënda e edukatës fizike elementare, e përdorshme për kategorit e ndryshme të fëmijvet:

1) Për ma të rijt (rreth 6-9 vjeç): lojna imitimi, lojna të thjeshta, qëndrime edukuese e përmirësuese rucjtje, ecje, tue këndue.

2) Për më të rritshmit (rreth 9-11 vjeç): lëvizje edukuese të thjeshta, lojna të thjeshta imitimi, ecje me kangë.

3) Për më të mbëdhjt (rreth 11-13 vjeç): si atyneve të 9-11 vjeç, tue shuem përdorimin e sporteve elementare (vrapime, kërcime, hedhje, ngjitje, bartje, etj.).

Elbasan, më 30 I/1937.

Spiro F. Shuteriqi

Kemi nevojë për njerës me karakter.

T' atillë që të mos thyhen prej vuajtjes dhe pengimit. Që të mos i ndryshojë jeta dhe të mos i kthejë turma, si kurse filizat e holla të pemëvev era e fortë.

Një element i tillë është i nevojshëm për çdo shoqëri njerëzore. Edhe në popujt më të përparuar, ku jeta shpirtrore dhe lëndore është rregulluar më së miri, ndjehet nevoja e një zhvillimi të përhershëm. Njerzit nuk janë të dënuar prej ndonjë Fati të verbër — si kurse besojnë disa — të vuajnë në fatkeqësitë e trashëguara. Jo, ata munt të përmirësohen e të zhvillohen. Porse këtë të drejtë do t' a gëzojnë vetëm at' here, kur të mos përtojnë për të vepëruar. Është e vërtetë se pa

mundim nuk bëhet asgjë. Porse asgjë nuk është e pa mundur për ata që fuqin' e mendimit të tyre e kanë të lirë e të pa kufizuar.

Po kush do t' a bejë gati këtë armë të pa thyer? A munt të fabrikohen ata shpirtira që nuk mboshten prej padrejtësive? Po. Të tillë do të formojë Shkolla burimi prej të cilit priet çdo lumtëri në botë.

Ajo nuk ka për qëllim vetëm që t' a pasurojë mëndjen e njeriut me dituri. Pse at' here do të armatoste me një mjet të fuqishëm një klasë njerëzish, e cila munt edhe të padrejtësonte mbi pjesën tjetër. Kështu, pa dashur, do të qe qerdhja e spekulatorëvev të nesërëm, duke mos sjellur

as një farë harmonije në vlerat shoqërore. Puna e saj do të kishte një drejtim negativ në krahasim me misionin që ndjek.

Por ndodhet edhe një tjetër, ku shkolla nuk shkakëton as një influencë përmirësimi mbi jetën Kjo ngjan, kur elementet që dalin prej 'saj nuk interesohen për asgjë.. Njerës të vdekur: as shërbejnë, as dëmtojnë; t'atillë që i mbulon heshtja dhe presin prej të tjerëve atë gëzim që munt t'a fitojnë vetë. Pra çdo veprim i fuqive të tyre shpirtërore dhe trupore munt të barazohet me asgjë.

Dhe me të vërtetë nuk janë të vlefshëm për shoqërinë; ata mjaftohen të grumbullojnë në trut e tyre një sasi njohnesh, regullash e formulësh të thata. Të dobishëm — me plot kuptimin e fjalës — janë ata që Dijën, si mjet, e përdorin më shpesh për qëllime e veperime të vlefshme. Passi ne e dimë që çdo prodhim mendjes së njeriut — përparimi i shkencave, i arteve dhe i gjithë diturive — nuk është një pun' e kotë, pse shërben për të lehtësuar nevojat lëndore e shpirtërore të tij.

Por nuk mjafton që vetëm njeriu të dijë të shërbejë, pse at' here nuk i a mbrin.

Porse nuk do të thotë se shkolla në një rasë të tillë ka një mundësi të kufizuar për riformim. Ajo një pjesë të këtyre elementeve munt t'a përpunojë gjer në një farë pike, duke zhdukur çdo ves që sapo ka filluar të rrenjosit në shpirt të kërthijnvet; ndërsa pjesa tjetër do të zhvillohet vetëm në një moshë të lartë, kur fëmija të zotërojë një pasuri shpirtërore e fizike më të plotësuar.

Kështu munt të themi që shkolla nuk formon karakterin. por bën gati themelin ku do të ngrihet ay; ndërtimi i tij, do të vazhdojë në jetë. Me këtë nuk themi se puna e 'saj ka një vlerë të shkallës së dytë në formimin moral. Aspak. Ajo duhet të krijojë njerëstëpavarur dhe mëndje-lirë. Jo parazita, por t atille që të jenë zotër të fatit dhe të dinë të gëzojnë çdo të drejtë në jetë, si shpërblim të punës së tyre.

Një detyrë të tillë të rëndë ka sido-

mos shkolla e jonë, e cila ka një përkrahje fare të vogël prej vatrës dhe shoqërisë.

Fëmijët t'onë, përpara se të venë në shkollë, qenë pjesëtarë të një rrethi të mjerë: viktima të pa fajëshme të mundimevet që pëson familja e tyre. Kështu s'e kanë ndërjerë vehten kurrë të lirë. Pra përpara se të bëhet një ndryshim radikal i shoqërisë në formë të përgjithëshme, shkolla duhet të vepërojë sistematikisht, duke lëfuar atë vuajtje, atë shlypje shpirtërore që ka ndërjerë fëmija në një vënt aqë të mjerë, si kurse familja e tij, e cila ka vepëruar mbi të si një burg. Shkolla duhet t'a lajë këtë mëkat që familja e bën pa dashur, ose sepse shtërngohet prej konditavet materiale e morale.

Ky duhet të jetë hapi i parë edukativ i arsimit t'onë. në qoftë se duam të formojmë njerëz me karakter. Në vëndet e qytetëruara shkolla gjen në shpirt të fëmisë një element të rërshtatshëm, të krijuar prej familjes dhe rrethit shoqëror.

Pra çdo edukator duhet të ketë parasysh nevojat intelektuale e morale të shoqërisë, në të cilën shërben. Mësimi dhe e gjithë vepra edukative e tij duhet të përshatet pas këtyre nevojave. Porse puna e mësuesit nuk mjafton vetëm që të përballë konditat e sotime të shoqërisë, por dhe t'i përmirësojë ato; ka një frymë përparimi Ay do t'a krijojë mietin që do vihet në shërbim të së mirës: qytetarin e formuluar moralisht, i cili do të lëftojë realitetin e hidhur të së tashmes.

Në shoqëri ndodhen padrejtësisra, ligje dhe zakone të pa arësyeshme, të cilat na i ka lënë si trashigira një edukatë e brezavet të kaluar. Këto të gjitha do të lëftohen prej dritës së dijës. Edukatori duhet të jetë kundeshitari më i ashpër i të gjitha turpeve dhe të metave shoqërore të kohës së vet.

Shkolla e Re duhet të jetë e gjithë-fuqishme. Ajo nuk do të përdoret si vegël e një grumbull interesash. por do t'i shërbejë në një mënyrë të pa kufizuar gjithë shoqërisë njerëzore.

Me këtë vepër transformojëse të ndër-

Kur i afrohem një fëmije më lejnë dy ndjenja: ajo e dashurisë s'ëmbël për tani, ajo e nderimit për atë që munt të jetë një ditë.

P A S T E U R

gjegjeve bëhët gati një ndryshim shoqëror, prandaj të gjithë edukatorët pa përjashtim që nga ay i qytetit dhe gjer tek ay i katundit më të largmë-duhet t'a ndejnë vehten e tyre si anëtarë të kësaj organizate riformonjëse. Mjafton që të duan; mjafton që të jenë pasionarë të së mirës së përgjithëshme.

Kështu "Shkolla e Biblioteka, do të

jenë falloret e shoqërisë së re. Shkenca morale do të jetë burimi frymëzues. Vjershëtorët, artistët, muzikantët, filozofët do të jenë profetët-mësues të 'saj. Leteratyra më fisnike e botës do të jetë bibla e 'saj dashurija dhe puna do të jenë sakramentet e shenja.

— '38.

Provë mësimi

Dhënë në klasën e 1-rë t'ushtrimore
më 3-11-937

Lânda: Gjuhë

Thema: a) Zhvillimi i gërmës
I e II

b.) Ushtrimi i këtyre dy gërma-
ve

Zhvillim

Hyrja: Si të vendoset qetësija e klasës. më. bën hyrjen duke e lidhur mësimin me atë të orës së parë, ku do të përfilleti midis të tjerave edhe kujdesi i një djalit për zogun. Këtu mës. gjen rast t'u thotë se ka edhe zogj t'atillë që nuk mërdhifin e rinë ngrofët; ata rinë mbrenda si na, e këndojnë; rinë brënda në kuti. Pyeten të thonë si e quajnë atë kuti dhe lihen të lirë të kallzojnë në kanë pam ndonjë kafaz me zok brënda dhe me ç'ka ushqehet. Mës. u tregon një kallëzim duke e përcjellur edhe me mimikën e duhur;

Përaqitja: Ishte një herë në një shtëpi një djalë i vogël, kaq sa ju, që quhej Lili. (Përsëritet) Lili rinte shumë urtë në shtëpi, i dëgjonte fjalët e prindërve dhe për këtë babai i bleu një bylbyl, i bëri edhe një kafaz e ja shtini bylbylin brënda. (Mës. vizaton në drasë me shkumza të ngjyrshëm një zok brënda në kuvli) Bylbyli çdo mëngjes këndonte shumë bukur dhe i zgjonte nga gjumi njerzit e kësaj shtëpie. Lili i vogël e donte fort këtë bylbyl dhe gjithë një vente afër kafazit ku ishte varur, e shikonte bylbylin, luante me të, gëzohesh dhe e bënte që të këndonte. (Imitohet kënga më parë nga disa e pastaj nga gjithë klasa). Lili e ushqente gjithënjë me kokra meli, por një ditë muer ca kokra gruni të mbëdhaja dhe po e ushqente, mirë po mbasi bylbyli i Lilit e kishte fytin të vogël, ç'thoni ju i ngjau? Nxën. Ç'farë gabimi pra

bani Lili? Nxën. ... Mës. imiton të përpjekurit e bylbylit për të nxjerrë kokrën e grurit që i kishte ngec në fyt, e në këtë kohë ay ja bënte l, l, l. ... Përsëritet e thuhet horas Lili, kur e pa bylbylin e vet që po përpiqej n'atë mënyrë dhe s'po këndonte më, si përpara por, qysh? Nxën. ... filloj të qante. Baba kur pa Lilin që po qante mori një copë tel të hollë, pakë të gjatë e me majë të kthyme e me kujdes të math që të mos i çponte fytin bylbylit i a nxorri kokrën e grurit. Mirë po a e dini ç'ndodhi? Si thoni ju a këndonte më si përpara bylbyli? Nxën. ... Mës. Po nuk këndonte më ashtu bukur si përpara sepse iu sëmure fyti atij, por tani kur donte më këndue ja bënte l, l, l. Këtë zë e përsëritin disa e pastaj e thonë prapë horas; në këtë mënyrë mësojnë mirë zanin e pas zanit formën e bylbylit, për të cilën vepron kështu: Po t'a qisim një herë jashtë këtë bylbyl dhe në këtë kohë vizaton në drasë afër kafazit një bylbyl, por kur e bën këtë bashkëpunon edhe me nxën. nuk ju kthen krahët atyre, por qëndron në një mënyrë që ta shohin nxën. nga fillon e si vepron; iu thotë për sqepin e bylbylit q'e ka futur nën fletët se asht sëmure prej fytit e kështu nuk i duket. Si t'a bëjë mës. ngrë 1 ose 2 fëmijë të bëjnë bylbylin e pastaj kritikohen nga shokët duke çfaqur edhe arësyes. — Pastaj bën një tjetër zok mës. e mbas kësaj ju thotë: Ata burrat e mbëdhenj bylbylin e bëjnë më shpejt se neve e bëjnë pakë të gjatë. Ata e bëjnë kështu: l (e bën afër të tjerave) dhe si e këndojnë? Nxën. l; përsëritet dhe thuhet horas. Pra, kur të shihni këtë juve ç'do t'u kujtohet? Nxën. ...

Tashti fillon të mësohet forma Mës, ç'ka i shohim më parë, thamë bylbylit? Nxën.

Ushtrimi i gërmës I Mës. Pa të shofim t'a bëjmë edhe ne një herë. Ky me dorën e majtë dhe nxën. me të djathtë bëjnë zogun (l) n'afër shumë-herë (bishtin, trupin,

kokën e këmbët). Pyeten si ja bënte lyl-lyli i Lilit kur i ngeci gruni në fyt; e përsëritin dhe e thonë horas. E bëjnë edhe disa herë n'ajër e pastaj mbi bankat. Si t'a stërvitin dorën mirë, më. ngrë nga 3 nxën. në çdo drasë të zezë dhe këta shkruajnë në 'to germën I Në këtë kohë nxën. e tjerë, për t'u stërvitur, e bëjnë n'ajër ose mbi bankat. Si t'i mbarojnë së shkruari ata që janë në drasë, i këndojnë gjithkush të vetat dhe pas këtyre i këndon një nga një e gjithë klasa. Nxën. me urdhërin e mës ulen nëpër bankat; mësuasi pyet gjithë klasën se kush e ka bërë më të mirë e kush më të keqe e pse. Mbas këtyre ngrihen disa nxën. të tjerë të cilët veprojnë porsì të parët.

Paraqitja e gërmës II.— Mirë ju thotë më. një bylbyl ja bënte I, I; Tashti babai, duke pa se Lili rrinte urtë në shtëpi, i bleu edhe një bylbyl tjetër e ja shtini në një tjetër kafaz të bukur e tani sa bylbyla ju bën atij brënda në kafaz? Nxën. . . Mës. vizaton një tjetër kafaz me shkumza të ngjyruem brënda së cilës ndodhen dy bylbyla. Lili i ushqente që të dy me kokra meli, por një ditë i dolli nga mëndja, mori kokra gruni e ja shtini bylbylavet. Çfarë ka ndodhë thoni ju? Nxën. . . Mës. Po tani si ja bënin ata? (Nxën, në mos e ditshin e thonë me ndihmën e mësuasit) Ata të dy ja bënin tash II, II, II; e përsëritin dhe e thonë horas. Si të dalij zani, mësohet forma Edhe për II veprohet po sikurse u veprua në I. Si t'a mësojnë zanin e formën më. ju thotë se burrat e mbëdhënj e shkruajnë kështu II (shkruan në

tabellë) dhe si e këndojnë. Nx. II i përsëritet e thuhet horas.

Ushtrimi i gërmës II.— Si t'a mësojnë, fillojnë t'a ushtërojnë sikurse I. Mandej më. i fshin të gjitha ç'ka janë shkruar në tabelë dhe bën n'atë vijat e shkrimit. I pyet ku do t'i shkruajnë ato në rrugën e gjerë a po të ngushtë e pse. Mës. mbush një rrjesht me I e një tjetër me II; I pyet sa zogj ka njëri e sa tjetri rrjesht. Këto më. i shkruan më bukurshkrim po kur i shkruan duhet t'a shohin nxënësit nga fillon e si e bën e të veprojnë edhe ata n'ajër tue folë qi t'i mbushij të dy rrjeshtat; vë disa nxënës t'i këndojnë. I shkruajnë edhe një herë n'ajër, përmbi bankat e me urdhërin e më. krejt me komandën 1, 2, 3. pllakat jashhtë; në këtë kohë më. u jep kalemat dhe me urdhërin e 'tij fillojnë të shkruajnë të gjithë nga ana me vija. Kur ata shkruajnë më. i kontrollon e i këshillon t'i shkruajnë me ngadale bukur e të rrinë mirë.

Dhe kështu vijohet duke shkruar gjersa të marrij fund ora.

Hysejn Hashorva '37.

Tabella e mësimi

I, I, I, I,
II, II, II, II.

V. R. Përveç këtyre germave tabella paraqet dhe dy kafaze; në njerën gjëndet një bylbyl q'i ngjan I dhe në tjetrin dy bylbyla bashkë në trajte të II.

NEKROLOGJI

Më 28 të muajit që kaloi, vdekja rrëmbëu nga gjiri i arësimitarëvet të këtij qyteti mësonjësin — Normalist

Haxhi Çiftja '32

E përkohëshmjia e jonë u paraqet prindërvet dhe të afërmyvet të të ndierit ngushëllimet.

Pas një lëngate të shkurtër dhe të fortë ndërroi jetë këtu n' Elbasan arësimitareja

Liria Zef Ko'ombi

Bashkëshorte e Profesorit t'onë, Z. Zef Kolombi Të gjithë nxënësit e Normales marrin pjesë me hidhërimin e profesorit të tyre. dhe i paraqesin me anën e "Normalistit" ngushëllimet.

Provë mësimi

Dhanun në kl. e IV t' Ushtrimores

Landa: Histori

Thema: Themelimi i Korçës

Zhvillim

Dispozicioni

- 1) Themelimi (gojdhana, dhe jeta e Koxho Mir — ahorit)
- 2) Zhvillimi i këtij qyteti mbas rrënimt të Voskopojës
- 3) Zaptimi i këtij qyteti prej të huejve.
- 4) Të hapunit e shkollës së parë shqip më 1884.
- 5) Zaptimi i këtij qyteti prej Grekve dhe më vonë prej Francezve.

Hyrja. Mësuesi lidhë mësimin e orës së parë me të dytin tue fillue: Korça a ka qenë për herë kështu si e shofim na sot? Nx ? Mës. Po si do të ket qenë në fillim? Nx

Mbassi merret mendimi i nxansve kallzohet prej mësuesit qëllimi i mësimit.

Paraqitja. Digjioni mësuesin këtu : Korça nuk ka qenë gjithherë kështu, por në fillim fare d. m. th. tash 450 vjetë ka qenë një fshat i vogël, dhe quhej **Pesë-shtëpi**. Mës. Pse thoni ju u quejtë kështu? Nx Mës. Pra në fillim fare kishte ket emën, dhe më vonë u qujt me ket emën qi kemi sot. Mës. Po si thoni ju Korçën, kush e formoi? Nx ? Mës. A thue, ka qenë ndonji njeri qi e ka formue? Nx Po pra, ket qytet e ka formue nji njeri. Ky njeri qe nji djaloc me emnin Ilo, i biri i nji priftit prej nji fshatit afër këtij qytetit, dhe ky jetonte në kohën kûr ishte nji popull këtu në vendin t' onë; cilli popull thoni ju ishte? Nx Mës. Turqit ishin të përhapun nëpër Shqipni, dhe na kishin zaptue krejt vendin t' onë. Sunduesi i tyne Sulltani, mbassi nuk donte të qindronte në Shqipni, ç' bëni ky?. Tue drashtë se mbassi të shkonte ky në Stambollë, populli do të

bante kryengritje, mblodhi djelmte më të mirë e më të fuqishëm dhe i muer me vedit qi në rasë se babat e tyne të bëjshin kryengritje, aj ç' do t' u bënte atyne? Nx ? Mës. Prâ do t' i mbytëte. Kështu në kët kohë mblodh shum djaloca nëpër Shqipni dhe ndër këto qe edhe ky Ilo-ja. Sulltani nder lufta qi bënte me anmiqët, këta djelmoça i vente në radhën e parë t' ushtris. Pse thoni ja i vente këtu? Nx ? Mës. Prâ Sulltani i vente në fillim me qëllim qi t' u vriteshin prej anmikut. Po të gjith ato qi shkojnë në luftë vdesin? Nx ? Mës. Pra nder gjith këto lufta qi bëni Sulltani me anmiqët, Ilo-ja pështoi dhe nuk u-vrâ; por bashkë me këtë pështoi edhe nji tjetër i cili jo vetëm qi përmendet edhe sot por e mësoni edhe ju. Kush është aj prâ? Nx. . . . ? Mës. Pra aj djaloshi qe Skandërbegu. Mës. Mbassi e pau Sulltani se Iloa ish trim dhe i mendshëm e afroi dhe e mbajti n' oborrin e vet. Mbassi Iloja shkoj në pallat të këtij si do të jetë rritë aty? Nx. ? Mës. Pra Iloja aty u-rritë mirë tue mos i mungue kurrgjâ. Sulltani mbassi e afroi afër vedit i a ndërroi emnin dhe e quejti **Ijzaj Beu** sikurse dhe Skander beut i cilli përpara thirrej **Gjergj Kastrioti**. Mës. Pra digjioni fëmi; këtë Ilo mbasi ishte djalë i sjellshëm, Sulltani e gradoi e e bëni si kryetar t' ahurave (ku u mbajshin kualët) t' oborrit mbretner, ku më vonë Sulltani prap i a ndërroi emnin dhe e qujti Koxha Mir-Ahori. Me qenë se Sulltani i besonte dhe e mbante si besnik të tij, e dërgoi si sundues (princ) i Janinës dhe në disa vende të tjera. Me qenë se ky ishte mërsitë mbassi nuk e kishte pa vendin e vet as prindët e vet për sa kohë, kërkoi prej Sulltanit qi t' a lironte. Mbas sa lutjeve qi i bëni e lëshoi dhe i tha: Shko atje ku ke le, dhe po ta nap me dekret qi ke me qenë sundues i fshatit t' and (qi quhesh fëshati Panarit) dhe i dy fëshateve tjerë. Koxha Mir-Ahori u nisë për vend të vet dhe filloj të përhapte bujqësin e industrin, dhe kështu këti fëshati i u shtunë edhe shumë shpija tjera. Në kët kohë Sulltani i dha emnin këtij qyteti "tue e qujtë **Gorxha** qi don me thanë", **Shif e**

Të nxitësh jetën, duke e lenë me një kohë edhe të lirë të shtjellohet, ja detyra e parë e Edukatorit.

M me MONTESSORI

shko. Ma vonë e qujti **Korxha** dhe në fund fare i dha emnin qi kemi ne sot Korçë. Me gjith këto përmirësime qi bëni Korxha-Mir-Ahori, u shtuenë edhe disa të tjera: Pse thoni ju? Nx. . . ? Digjoni mësuësin. Pranë Korçës ishte nji katund me emnin Voskopojë; ky ishte shumë në lulzim dhe përshinte 100000 banorë, por ky qe djegë dhe populli i këtij qyteti tue ndi përparimet qi po bënte Korça, ç' farë bëni thoni ju? Nx. . . . ? Mës Erdhën e u vendosën në këtë vend tue punue këto toka Mës. Kur ky fshat i math filloi për me u smadhue pak u-versulën anmiqët dhe këto qenë të shtërguemë t'ikin ndër shtete tjera si në Rumeni, Egjipt dhe n' Amerikë. Mbassi iku anmiku, kthej populli prap në vendin e tij tue u-zhvillue më tepër se përpara Por me gjith këtë lulzim qi ishte mungonte diçka se fëmija si ju ku do të shkojshin? Mës Pra ky popull qe i pari qi formoi shkollën shqype (1894) dhe pastaj fëmija shkojshin me mësuë shkrim dhe këndim Ky popull pat prap edhe disa trazime, pse herën e parë e trazuenë Grekët dhe herën e fundit e trazuenë Françezët. Me të dalun të këtyne anmiqve filloi prap të përmirsohet dhe arriti në kulmin si e kemi edhe sot. Mës. Kush do të më thotë se Korça a është ma e përmirsueme se çdo qytet tjetër? N. ? Mësuësi u tregon arsyet se pse Korça është ma e bukur (e rregulltë) pse populli i sajë e shumta ka qenë në mërgim dhe mbassi Korça u shlrue prej të huaje, këta u kthyen nga mërgimi dhe mbassi kishin sjellun me vedit para, goditnë shpijat e tyne të bukra sikur i shofim na sot; punuenë tokën dhe hapnë industrin e tregëtin.

Në qoftë se del koha bëhet nji përmbledhje e shkurtë prej ndonji nxanësit i ndihmuem prej pyetjeve dhe udhizimit të mësuësit.

Frano Preçi '37.

Provë mësimi

Dhanë në kl. të V. t'Ushtrimores
më 8. II. 1937

Landa: Gjuhë

Thema: Diktimit mbi përemnat
pronorë

Zhvillim

Hyrja. Mës. për me fillue mësimin u

sjell nxansve këte pvetje: i keni mësuë përemnat pronorë? Nx. . . .

Kush do të na i thotë disa përemna pronorë? Ngrehet nji nxanës edhe thotë: i ëmi, i yti, e emja, e ytja etj.

Mës. Në këtë orë do të mësojmë si shkruhen këta përemna pronorë. se shumë prej jush kur i shkrueni bëni gabim. prandej sot do të shofim si shkruhen qi të mos bëni më gabime. Këtu u diftohet nx. qëllimi. qi t'a përmbledhin vedin përmbi landën, qi po zhvillohet

Paraqitja. Kur thomi im amë. si mund ta thomi ndryshe këtë? Mbassi të ketë dalë qëllimi i pyetjes, bëhet analiza gramatika le, tue thekësue sidomos përemnin pronor. Po përse e shkruejmë na im amë e jo ime amë? Nx. diftojnë arsyen; në rasë se nuk del prej tyne, u diftohet prej mësuë arsyeja e dy zanoreve qi tinglojnë keq në vesh. prandej i vëmë apostrof (') Mës. shkruen në drrasë të zezë edhe shumë shembulla të tjera me të tilla përemna, tue u-puttë nxanësve domehtanjen e tyne dhe mëndyren si shkruhen, tue veprue si në shembullën e parë p. sh. **Robja e s'ime mesë, i thashë s'at amë thuej t'yt 'et etj.** Të gjitha këto shkruhen në drrasë të zezë.

Thellim. — Mës. tregon se përpara emnave të gjinis mashkullorë vënë nyjen i dhe t' kurse përpara emnave të gjinis femnore vëmë nyjen e dhe s'.

Për me kuptue mirë nyjet bëhen disa shembuj ku të kenë mbrenda këto nyje p. sh. Libri i t'et 'et për mashkullorë, e çarapi i s'at 'amë për femnore etj. Të gjitha këto prap shkruhen në drrasë të zezë. Tash u thotë Mës. qi t' i shikojnë mirë ato qi u-shkruen në drrasë të zezë, se un do t' i prishi e ju do t' i shkrueni në diktim.

Ushtrim: — Mës. u ndanë nxansve fletoret e diktimit për t' i ushtrue nxansit n' orthografin e këtyne përemnave pronorë. Mës. formon disa fjali me fjalë qi u folen më nalt Në midis të fletores u-thohet që të shkruenë diktim nbi përemna pronorë. Gjatë diktimit Mës. u përflet fjalit kthielltë, ngadalë e me kuptim; dhe vë re nxansit se a thue e kuptuenë fjalën e mësuësit.

Gjatë diktimit Mës shkon tue verejtë nxansit si shkruenë, dhe merr në shënjim gabimet e bëme të cillat i shkruhen në

drrasë të zezë, tue u thanë: po shof disa prej jush se po e shkruajnë kështu p. sh. t'yt et.

Diktim

Mbi përemna pronorë

Im 'atë e yt 'atë, janë miq.

Jot 'amë me t'yt motër, erdhë tek im 'amë. Un, s'im 'amë e t'im 'et u shërbej për herë. Kapela e s'ime mese dhe robja e t'im nipi nuk vijnë për t'yt mesë e për t'yt nip. Lejlek haxhibeg thuej s'at 'amë e t'yt 'et. . . . etj.

Mbassi të mbarojnë të shkruemit mes. u-thotë nxanësve qi të shikojnë mirë ato qi kan shkru, mos knaë bā ndo i gabim e posaçërisht të vërejnë përemnat pronorë se këtu asht i tanë qëllimi i mësimi t'onë.

Tabela e mësimit

Yt 'atë, im 'amë, s'ime mbesë,

s'at 'amë, t'yt 'et, s'ate mbesë,

t'yt nip, t'im 'ungjë etj.

Paulin Çapaliku '37.

Rabindranat Tagor

Çpifje

Sytë e tua, përse i ke të njomur, djal i im? Përse ata të bëjnë të vuash në çdo kohë? Kur shkruan, i lyen duart me bojë . . . Për këtë punë të quajnë fajtor dhe të thonë, i fëlliqur? Leri ata më nj'anë! Hënës që është e ndyrë me njolla nuk mund t'i thonë e fëlliqur! . . . Për gjëra më të vogëla të shajnë, djal i im . . . Ata gjith-nji duan të të gjejnë mungesa . . .

Duke luajtur i ke grisur rrobot t'ueja. . . Për këtë punë të thonë se je i poshtër? Leri ata më nj'anë . . . Agimit nëpër mes të revet të grisura të vjeshtës, ç'do t'i thonë? Se ç'thonë ata mos i merr parasysh djal i im! . . .

Ata numurojnë një nga uji mbrapsh-tësirat t'ueja.

Gjith kush e din se ti i do gjërat e

ëmbra. Për këtë punë duan të thonë se je grykës? Leri ata më nj'anë . . . Po ata çdo të na thonë neve, që të duam? . . .

GJYKATËSI

Ju, si të doni mund ta gjykonim! Unë e njoh fare mirë mungesat e fëmij s'ime. Unë e dua, jo për arsye se është i mirë, por pse është djali im . . . Sikur të krahasoni të mirat e t'ij, me të metat që ka, si do ta cilsoni?

Kur unë e dënoj, ai bëhet një copë e ego-s s'ime Kur i shkaktoj lotet e syrit edhe unë qaj bashkë me të, me zemër.

Atë mund ta dënoj vetëm unë . . . se pse ai që e do, e rreh!

VALET DHE RETË

Nënë! Ata që rrijnë në mes të revet më thrrasin dhe më thonë: "Qysh nga të gëdhirët e mëngjesit, gjer në të perënduar të diellit, këcejmë e lozim," "Këcejmë me rrezet e arta të diellit, lozim me hënzën e ergjendët të qiellit."

Unë i pyes: "Si do të mund të arrij gjer atje," Ata më thonë: "Afrohu në skaj të botës . . . zgjati duart në qiell . . . do të të ngrejme gjer në retë e hapsirës . . ."

"Nëna më pret në shtëpi i them unë "si mund të vij atje e të lë nënën vetëm?," Me këtë fjalë ata qeshin dhe duke qeshur ikin dhe arratisen.

Mirë, por unë dij një lojë më të bukur se kjo, nënë . . . Unë do të bëhem një re dhe ti do të jeshë hënëza. Unë ty, me të dy duart, do të të përqafoj, dhe pullazi i shtëpis s'onë do të bëhet qielli . . .



Ata njerës që rrijnë në mes të valëvet më thërrasin dhe më thonë: "Qysh nga mëngjezi gjer në mbramje, lozim e këndojmë Gjithnjë shkojmë e përparojmë; por se ku vemi dhe ku shkojmë, nuk e dijme."

Unë i pyes: "Si mund t'ju vij pranë?," Ata më thonë: "Afrohu në buzë të ujit, mbylli sytë mirë e mirë . . . "pastaj neve vijnë e të marrim . . . "Unë i përgjegjem: "Mëma ime kërkon që të më shohi në

çdo mbrëmje... Unë si të bëj? Si mund të lë vetëm nënën t'ime? Ata qeshin dhe duke kërcyer më rradhën e tyre ikin dhe arratisen....

Mirë po dij një lojë më të bukur se kjo... unë do të bëhem valë e detit dhe ti do të jeshë bregu i huaj.... Unë do

të rrotullohem dhe do të nxitoj të prehem në krahun tënd, duke qeshur dhe duke kënduar. Bota nuk do ta dijë se ku jem unë e ti.....

E përktheu

Sadi Pejani

Ernest Renan

Shërbimet që u sjell shkenca popujve.

Shkenca e pastër, përveç se nuk është vokane për demokartinë, i sjell asaj shërbime të mdhaja dhe ndihmon më shumë se çdo gjë tjetër qëllimin e math të demokrtias, që është liriimi e përmirësimi i popullit.

Një gjë e qartë është në fillim: çdo zbulim praktik i mendjes së njeriut lidhet me një përparim moral, me një përparim të meritës të gjithë njerzve. Vëreni një anije të vjetër, një nga anijet e mdhaja të Greqëve: mjaftë t'admiruara për ndërtimin e tyre; kush është motorri? Është forca e krahëvevet. Në ijët e kësaj anije të bukur gjindet një ferr; gjinden atje qindra njerës të vënë njëri mbi tjatrin në një mënyrë që mezi merret me mend, të cilët lëviznin lopatat e bënin t'ecte anija, duke shkuar një jetë me rënkime të përjetëshme e duke qënë të shtyrë në punë mizore.

Kjo gjë ka zgjatur po thua deri në ditët t'ona; ne kemi pasqyra të pjesës së mbrëndëshme t'anijes nën Louis-in XIV të, ishte një punë shumë e vështirë, e shumë e arësyeshme është që emëri i anijes ka mbetur sinonim i punëve të tmeruara e të forcuara.

Përse këto tmerre? Një rrit nuk njihnin forcën llastike t'avullit, arti i lundrimit ish e

pakë i përparuar. Krahët e njeriut drejtisht të zënë me lopatat, ishin të vetmit që shtynin përpara. Merrni anijen t'onë më të madhë: shuma e forcave muskulore të haxhuara në punë është po thua asgjë.

Në kohën e vjetër kishit një punë tjetër po thua aq të rëndë se sa ajo e lopatës: ishte ajo e mokrës. Nuk kishte as një mulli me ujë, as me erë; gurin e shypnjin me anën e krahëve duke përdorur dy mokra. prej të cilave njëra ishte konike e tjetra futesh në të parën. Të rotulluar mokrat ishte sinonim i dënimit më mizor.

Edhe çpikjet më gjaksore i kanë shërbyer qytetërimt. Përpara topit me barut ai, që kishte një kalë të mirë dhe armë të mira, ishte shumë më i lartë nga njeriu i varfër i paarmatosur, sa që ky i fundit përkulesh përpara kalorsit. Që prej topit me barut kryesija e kalorsit, e zotniut feodal është zhdukur. Çdo njeri, sa do që të jetë trim, është i njëjtë me të tjerët; qatë herë janë krijuar Shtetet t'ona të mdhaja, kundërshtarët e feodalizmës. As gjë nuk provon më mirë se sa kanë ndihmuar popujt sho shoqin. Një zbulim i bërë në një cep të botës bëhet shpëtonjë, vegël e përparimit të cepit tjetër; një dijetar i vetmuar zbulon një ligj të natyrës, dhe ky ligj i

Pedagogjija e re duhet të bazohet mbi vretjen e mbi eksperiencën: ajo duhet, përpara të gjithave, të jetë eksperimentale me kuptimin shkëncor të fjalës

ALFRED BINET

njohur mirë, bën të zhduken vuajtje, dhëmbje dhe turpe trashëgonjëse

II

Forca e avullit a mos ka qënë gjetur rasësisht e pa teori? Aspak. Papin¹-i, Wat²-i ishin dijetar, dijetar shumë të thelluar, dhe pa prova të gjata nuk do të kishin mundur të bënëin këtë zbulim, që numërohet nga një më të jashtzakonshmit që mundemi të kallzojmë... Ndriçimi elektrikor ka zanafillën e 'tij në të njohurit e një force fare pakë të dukëshme në natyrë.

Përparimet e lundrimit i detyrohen njësisht shkencës Krahsoni lundrimin e sotmë me atë të kohëve të para: sa ndryshim! Përpara shkonin prej një kepi në tjetrin e kishin frikë se mos humbnin tokën nga sytë. Tani guximi i lundronjësve nuk ka kufi. Kujt u detyrohen gjithë këto përparime? Galileu³ e Newtoni⁴. Caktimi i gjatësisë e i gjërësisë gjeografike, problem themelor i lundrimit, ka qënë zgjedhë vetëm prej zbulimeve të thella, prej të cilave kanë dalë procedime që çdo detar i thjeshtë i përdor pa u menduar aspak. Pra kujtoni se ç'qënë Galileu e Newton i: dijetarë që merreshin me teorinë, të dhënë krejt mbas problemave abstrakte e mbas hesapesh shumë të lartë. Hesapet e Newton i veçanrisht ishin aq të lartë, sa që në Evropë të shumtën dhjetë vetë munt ti ndiqnin e ti kuptonin e që vet Newtoni në disa çase kishte vështirësi t'u gjente fillin.

Agronomija vet, kjo industri krejt praktike, ka nxjerrë fitime në shumë gjëra prej shkencës abstrakte. Shihni këto maquina bujqësore, këto maquina shirëse, sa mundimeve të krahëve u ndihmojnë. Kujtoni një herë sa i rëndë ishte më parë të korrurit; tani një maquina e kryen tërë punën dhe i zhduk mundimet. Sillni ndër mënd se ç'farë kryengritje ka prodhuar në pasurit popullore fabrikimi i sheqerit të panxharit.

Edhe plehrat kimike! Ja akoma dhe një zbatim drejt për së drejti i shkencës. Përpara, para përparimevetë të kimis i merrnin trupat e natyrës si gjëra të ndërliku-

ara dhe i çmonin si të filla: shkonin për t'i gjetur fort larkë me mundime të mda. Tani, që njihen elementet, merren atje ku gjinden, bëhet prapë njazimi dhe nuk jemi të detyruar t'i gjejmë me mundin atje ku natyra i ka vendosë. Prej kësaj gjeje kemi kurcime të mda, e çdo kurcim është një fitim për një popull, mbassi mundet kështu me pakë punë të fitojë një trashëgim ose një nevojë.

A nuk duhesh të përmëndja të mirat që i detyron njerzimi përparimit të fiziologjis të shkencave të jetës? Më parë një filan sëmundje mbahesh si e pashëruar; tani e shërojmë rënjësisht në disa minuta.

A kam mundur t'u tregojë që këto studime, në dukje të kufizuara në një numur të vogël, janë nënet pjellore të zbulimeve, prej të cilavet përfitojnë të gjithë? Akam mundur t'u rrëfenj që populli ka një interes të math që të ketë dijetar që të punojnë për të madhuar rrethin e njohunive njerzore; që zbulimet më të bukura dalin prej punëve në fillim të rërta e të vetmuara?

Jam bindur se përparimi i mekanikës, i kimis do të jenë blerja e puntorit; që puna lëndore e njerzis do të shkojë duke u pakësuar gjithënjë e duke u bërë më pak e rëndë; që në këtë mënyrë njerzija do të bëhet më e lirë për t'u dhënë mbas një jete të lumtër, morale e intelektuale. Dojeni shkencën. Nderoeni e besoeni, është mikja më e mirë e popullit, garantija më e sigurtë e përparimeve të 'tij.

Shqipëruar nga

Faruki Vroni. "V. D. V.,"

1. Papin: fizikant frances i shekullit XVII-të; çpiku maqinën e parë me avull.

2. Watt: fizikant Angles i shekullit XVIII të i sollti maqinës me avull përmërsimet e caktuara.

3. Galileu: astronom i famshëm e matematikan italian i fillimit të shekullit XVII; që i pari që njohu që toka rrotullohet reth diellit

4. Newton i dijetar Angles (1642-1727) zbuloi ligjë të cilavet u binden lëvizjet e trupave qiellorë.

Kallëzime Patriotike

Fshatari i vogël dhe
Skënder-beu

Ishte një ditë e bukur me diell në mbarim të dimrit. Dëborë zbardhonte mbi majat e larta të maleve, por fushat përposhë kishin zënë të gjelbëronin. Bujqët e fshatrave përpëra Krujës ndienin frymën jetëdhënëse të prendverës, sa herë që, me shpirt të gëzuar vështronin të lashtat e tyre, që bleroheshin shumë e më shumë.

Kësaj dite të qeshur, mbi qoshkun e një shtëpije të veçuar të katundit Larushk, rrinte një burr i thyer në moshë, i cili, me sqeparin e tij të math, po gëdhente një dru të fortë lisi. Ishte Marku i Prele Gjoni dhe përgatiste një dorës të rë parmënde. Në punim e sipër, lëshoi sqeparin më një anë dhe u-zgjatë të marrë peshqirin nga parmaku, për të fshirë djeshën. Pa dashur i vajtën syt nga yrti i vet që kishte mbjellur grurë dhe, mbassi bëri një të verejtur plot kujdes me dorë në ballë, rrudhi vetllat dhe i thirri djalit të tij trembëdhjet vjeçar:

„Gjoni! Gjoni!”

„Urdhëro, babë!” i u përgjegj i biri, që po i ndihte s'emës dyke prerë dru në oborr.

„Shkë mbylle shpejt shtegun e yrtit t'onë dhe mos lër asnjë njëri të hyjë brenda!”

Në largësië dukej një tufë kalorsish gjathtarë, që po vinin drejt yrtit të Markut, për të gjojtur pyllthin që ndodhej aty brënda.

Gjoni me të ndëgjuar urdhërin e t'et, lã sopatën, mori shkopin e vet prej thane dhe vrapoi ke shtegu, të cilin e mbylli pak gjë përpara se të hynte kalorsi i parë.

„Çile shtegun djalë!” urdhëroi kalorsi, dyke shtuar, ne vimë të gjojmë atë pyll aty brenda!”

„Unë kam urdhër mos ta çelë” i u

~përgjegj djali, dhe as ju lë të hyni brenda, se prishni grurin.”

Hajde shpejt dhe çile, se ndryshe zbres unë dhe t'a shkulë veshin pastaj!” i u kërcëua kalorsi

„Kurr s'ta çelë dhe as që të lejoj t'a bësh një punë të tillë!” i a priti djali pa u-trëmbur.

Ndër kaq u grumbulluan gjith' kalorsit e tjerë para shtegut të ndaluar dhe ja nga mezi i tyre doli një i qetë, por i fortë si prej luani:

„Hape shtegun, bir!”

Kalorsit e tjerë, dyke u-larguar djath-tas, i liruan rrugë zotriut që foli. Gjoni i vogël pa një burr me mjekërr, mbi një kalë të bardhë, që po i afrohej madhërisht e me nga dalë. U-trondit nga pamja e tij dhe ndoshta do t'a kishte hapur shtegun po të kishte guxim të lëvizte më një ças, por ndërsa rrinte ashtu i habitur, i ranë në ment fjalët e t'et, mori zëmër dhe foli:

„Zot kam urdhër prej t'im eti dhe s'mund t'a hapë.”

„S'ka gjë” i a priti Kryekalorsi, t'urdhëroj unë që t'a hapish!”

„Unë njoh vetëm urdhrin e t'im eti dhe s'mund t'ju bindem kurrsesi!” i a ktheu djali i paundur.

„S'ka shteg që mos të hapet para meje, djalë” foli Kryekalori me zë të lartër. „Unë do të kaloj këtu bashkë me shokët e mi. Mëso se mua më thotë Skënder-beu

Sa po ndëgjoi atë emër të madh e të dashur, djali bëri tri hapa pas, hodh shkopin përdhë. Ju përfalë në shenjë nderimi dhe pastaj, dyke e shikuar drejt në sy, i tha:

„Mbreti im i Lartë i do me gjithë zëmër djemët që binden n'urdhrat e të par-

vet tyne. Madhështi e tij nuk do të dojë që unë të thyej tani urdhrin t'im etil!

Skënder-beu buzë qeshi dhe, dyke kthyer kalin prapë, u tha të tjerëve:

„Me një ushtri si ky, mund të push-tonja gjithë botën!“

Kalorsit u-larguan në drejtim tjetër

dhe Gjoni i vogël u-kthye me vrap nga shtëpia, dyky thirrur me gëzim:

„Hurrá! Hurrá; Unë bëra atë që s'mundën dot t'a bëjnë as dy sulltana! Unë ktheva prapë Skënder-benë!“

Adaptim nga
Beqir Çela.

Novelë

Kristina

Vaso Koroveshi sot në mëngjes mori këtë letër të pikëlluar nga shoku i 'tij Pal Gjinoshi :

“ I dashur shok,

... nga fshati më vjen një letrëzë e vogël me dy-tri fjalë të pikëlluara:—**Kristina sot ndroi jetë! Rrofshit vetë.**—As gjë më tepër: Kristina ndroi jetë! Kristina vogëlushë, Kristina dymbëdhjetë muajshe nuk gjindet më dhe... ja zemra m'u-trondit e sytë po atë çast filluan të lotojnë. Çurkë nëpër faqet shkojnë lotët, rëndë tronditet zemra, kurse mendja aty për aty mbi fotografinë e vogëlushes, që shtrëngonja në gj, filloi të çfletësojë të shkuarat, të sjelli kujtime:

... Një vit më parë mora lajmin për lindjen e Kristinës. Në vet-vehte me atë lajm u-mahnita dhe një ndryshim personaliteti sikur m'u..bë, kurse ndjenjat përpëitëshin në një gëzim të përzierë. Babë unë?! Përpara realitetit heshta, medje edhe kisha turp ta kujtonja.

Mbrënda javës jetova n'agoni të madhe: Kërshëria për të parë krijesën e gjakut t'em më shtoej me të madhet or'e çast. Një pasqyrim të çuditëshëm të vet vehtes ëndëronja tek ajo. Më së fundi u-nisa për në fshat për të shuar kërshërinë. Së largu dallova shtëpinë t'ime: Tani nuk kujtova më vetëm gruan t'ime si herët e tjera, kur vinja, por për brij 'saj mendova edhe fëmijën t'ime Po afrohesha me çape të shpejta e shpejtësia e të rahurit të zemrës po më shtoej. Ja edhe një çap, ja edhe një tjetër dhe... ngjitem nëpër shkallët. Ma-

maja më pret e gëzuar dhe më përqafo, por gruaja nuk më del përpara si më parë.

— Ajde, biro, hyrë.— më thotë mamaja me të qeshur — Ajde se na u-shtua njerëzia. Na rrofshit sa malet, bir-o, e na u shtofshit!

Kapërxej prakun e derës si i druajtur dhe hynj mbrënda në dhomë: më një kënd në këmbë shoh gruan t'ime, që po më shikon me buzën në gas e për brij 'saj një djep Qëndroj një copë herë në mes të dhomës, përmbledh vehten dhe e shikonj gruan t'ime edhe unë me buzën në gas e pastaj sytë i hedh te djepi me mall, por edhe si i turpëruar. Edhe ajo i uli sytë drejt djepit e filloi ta tundij. Unë çap s'kujtoj të hedh përpara, kurse përmbrenda vet-vehtes s'dij se me sa tronditje e me sa agoni po qëndroj.

— Afro-u, bir-o, afro-u, të shohish se sa çupkë të bukur kemi. Ajde, mos ki turpë.— më thotë mamaja dhe m'afron foshnjen e mbështjellur në pelena. Unë drubem, kurse gruaja e ime sikur po më shikon tani si me përmallime.

— Na, merr-e në prehër.— më detyron mamaja dhe ma jep. E marr ndërmjet dy duarvet dhe e shikonj me habi: një fytyrë të vogël, një fytyrë qumështore pa shenja të forta dallonjësë hë për hë kam në duar: I mbledh buzët, i mbyll sytë dhe lëvis kryet: shenja gjallërie të krijesës s'onë!

— Puth e, puth-e, për kokën t'ëndë.—më thotë mamaja dhe m'afron në buzë, e unë... përulem dhe e puth në ball: putha gjakun e gjakut t'em, mishin e mishit t'em! E, duke puthitur buzët e mija mbi ballin

e foshnjës, fët e fët më lindi qëllimi i punës s'ime dhe shija e jetës s'ime.

Kaluan disa muaj e Kristina vogëlushë po ritej e po zbukurohej dita-ditës. Ajo tani na u-bë drita e gëzimi i familjes: duar më duar e buzë më buzë po shkonte te rrethi familjar. Ajo vetëm qeshte, qeshte e na shikonte drejt në sy me ëmbëlsi të madhe. Më von filloi t'i njohi edhe njerëzit nga fytyra e të përqëndrojë emrin e 'saj. Me syt e 'saj të mbëdhë e përvehtësonjës ndiqte me verejtje të madhe çdo lëvizje të s'ëmës nëpër dhomë, e, kur i thërrisnim ne po n'atë kohë:

— Kristinë, Kristinë, moj, . . . Xall—ajo fët kthente kryet nga ne edhe qeshte, atëhere qeshnim edhe ne bashkë me të. Shpesh herë kur e trazonim a kur e gudulisnim, ajo bëhej serioze dhe ankohej me fjalë:

— Mëm, mëm!— E gëzimi për ne arinte kulmin, kur me dockat e 'saj të vogla na tërhiqte mbas flokëve.

Për dashurinë e 'saj të vajturit në shtëpi e shpeshova: dita-ditës bëhej më e bukur, më e dashur e më e gëzueshme: me të qeshur zgjohej nga gjumi, me të qeshur bënte banjën, me të qeshur mirte ushqimin e me të qeshur vihej në gjum. Kur zgjohej rastësisht në mes të natës, e mirrnja në prehër, kurse ajo, e mbështjellur si ishte në pelena herë më shikonte mua, herë t'ë mën e më fort sytë i ngulte te drita e llambës. Kohë të gjatë rinim të zhytur në ëndërrime të tilla birnore. Kur fillonte të kotej, fërkonte hundën e sytë, mbështetej në krahët e s'ëmës edhe fillonte kinse t'ankohet:

— Mëm mëm! . . . ëë, . . . ëë, ëëë!— Atëhere e vinim në gjum duke e tundur djepin që të dy e dyke i kënduar ulët.

Me Kristinën tani jeta më dukej më e ëmbël më e gjallë. Kur e shikonja, më bëhej sikur më lindëj në djell në zemër edhe, kur e mirrnja në krahë, harronja çdo brengë shpirti. Syt e 'saj, fytyra e 'saj, duart e 'saj, e qeshura e 'saj mua sikur më magnetizonin.

. . . . Dhe pastaj na vdiq, vdiq në pre-

herin e nënës së 'saj. Ajo që hoqi dhimbjet e lindjes, po ajo i vuajti edhe dhimbjet e vdekjes së fëmisë së parë. Mbas lajmit të pikëlluar, kur vajta në shtëpi, mamaja nuk më priti me të qeshur si një vit më parë: ajo më përqafoi dhe mbushi sytë me lotë pa mundur as të më ngushëllojë me një fjalë të vetme. Babaj e vëllezërit më shtrinë duart kokë ulur e pa zë. Gruaja nuk vuri buzën në gas, as që doli të më presë me Kristinën në krahë si bënte heret e tjera: Atë tani e gjeta të strukur mbi një kënd të vatrës me shenjat e zisë e pa djep pranë. Rinte kokë ulur dhe vajtonte shpirtin e humbur. E shtërngova për dorë dhe e shikova dhimbshëm drejt në sy, kurse ajo me pikëllim të math m'i hodhi syt e 'saj të lotuar.

— Mos qaj se jemi të rinj, — i thashë. Ajo më shikoi ngultas e pikëlluarshëm edhe një herë drejt në sy e pastaj përsëri uli kryet pa folur gjë, veçse u shkri më keq në vajë. Unë s'durova më tepër: u hoqa në dhomën t'jetër dhe fillova të qanj: qanj Kristinën, qanja kujtimet e 'saj, qanja dhimkën e zemrës s'ime.

Mbas dreke vajta te varri i vogëlushes: Ç'përshypje e tmerrëshme ishte, kur mendonja se nënë atë grusht dheu e nënë atë grumbull gurrësh të tretesh Kristina e jonë, Ajo që na mbushi me ideale e na dha jetë për vit të tërë! Tmerr! U-gjunjëzova dhe putha një pjesë të varrit për dashurinë atërore t'Asaj që tretej përmbrenda 'tij, e, . . . dyke puthisur buzët mbi atë varr e me lotet, që u-derdhën, fët e fët më vdiq edhe qëllimi i punës s'ime edhe shija e jetës s'ime! U-bërra përsëri njeri pa ideale shpirtërore!

Me shumë mall "Pati,

Vasos i u-mbushën sytë me lotë e dyke e mbyllur letrën, pëshpëriti: — Fatziu, Pal! I perëndoi edhe i vetmi ledhatim i zemrës së 'tij të ngurosor!

Stjerjo Spasse.

Posta e Jonë.

- S. Papparisto — Gënevë — U lajmërojmë me letër, të fala.
N. Babameto — Tiranë, do të botohen.
H. Ruhi — Tepelenë — U shkruajmë në letër të veçantë.
P. Ikonomi — Fier — Muarëm, me qenë se erdhi vonë
mbetet për numrin tjetër.
S. Spasse — Korçë — Kristina u botua, artikulli tjetër për numrin e ardhëm. Të fala.
S. Pejani — Kolonjë — Muarëm, po e botojmë u faleminderit. Na pëlqejnë pjesët e bukura të shkrimtarit Hindian, presim dhe më.
I. Sh. — Peshkopi — Do të botohet.
A. Andriku — Nuk kemi marrë gjë nga ju.
F. Angoni — Bilisht — Me qenë se kemi lëndë t' asaj natyre e shtyjmë për më tej.
Qukapiku — Tiranë — Muarëm, u falnderojmë.
Shkrimet t' uaj letrarë na pëlqejnë.
A. Idrizi — Delvinë — Muarëm, u faleminderit.
K. Ylli — Lyon — Presim — Të fala.
P. T. " Leka „ — Shkodër — Në qoftë se nuk e bëni dhe ju detyrën kundrejt Normalistit, nuk do t' ua dërgojmë.
I. Dedushi — Vuno — u shty për më tej.
V. Nasto — Himarë — Mbeti për numrin tjetër.
P. T. Instituti " Nëna Mbretreshë „, muarëm, u falnderojmë.
T. Gusho — Korçë — Muarëm të hollat, presim dhe të tjerat.
I. Guri — Kelcyrë — Muarëm, u faleminderit.

